



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:010189  
Datë: 24.10.2024  
Numri i dokumentit: 06345115

C.nr.2598/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit B.K. nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bunjaku, avokat në Gjilan, me adresë Rr. "Skenderbeu", H-42, K-II. Nr. 3, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Valdete Rudi, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 659.00 euro, jashtë seance, me datë 24.10 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësi B.K. nga Gjakova, me cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, që paditëses së lartcekur të ia paguaj vlerën e një page bazë në shumë prej 659.00 euro, në emër të pagës së 13 (trembëdhjetë), për vitin 2020 me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi Butrin Kusari nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tij, me datë 21.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në Prishtinë, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën, me kontratë në kohë të pacaktuar me detyrat si mjek specialist gjinekolog. Ka shtuar se paditësja në bazë të listës së pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për vitin 2021, ka pagën bazë prej 659.00 euro. Tutje ka theksuar se duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, konkretisht nenin 17 paragrafi 2, paditësja disa herë ka kërkuar verbalisht nga e paditura si punëdhënëse që të ia paguaj pagën e trembëdhjetë, mirëpo e njëjta nuk i është përgjigjur në kërkesën e paditëses si dhe nuk i ka kryer obligimet që dalin nga KKS-ja. Andaj,

paditësja ka paraqitur padi ku kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin të bëjë pagesën e kompensimit në shumës prej 659.00 euro në emër të pagës së 13, për vitin 2020 me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcenim të përmbarimit si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj Valdete Rudi në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 09.10.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar dhe të pathemeltë me arsyetimin se ky kompensim paditësit nuk iu takon pasi që nuk ka bazë ligjore për shkak të skadimit të Kontratës Kolektive Sektoriale 2018-2021. Tutje kaka parashtruar se padisë së paditëses i mungon baza ligjore, pasi që bëhet fjalë për kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021. Ka theksuar se sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të KKS-së, e njëjta interpretohet duke u lidhur me ekzistimin e mundësisë për një shpërblim të tillë, siç ka paraparë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik me numër protokollit 212/2023, të datës 09.10.2023, andaj edhe i padituri SHSKUK si organizatë buxhetore ka pasur mungesë të buxhetit nder vite në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, edhe përkundër planifikimeve, i njëjti asnjëherë nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tremujorin e fundit TM3 të çdo viti, vazhdimisht ka pasur deficit në paga dhe është plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta, siç provohet edhe nga njoftimi i lëshuar nga Drejtori Financiar i SHSKUK z. Enver Gashi, me numër protokollit 3823, i datës 21.12.2023. Po ashtu, ka parashtruar se edhe Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka mundësi buxhetore të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13, siç provohet edhe nga përgjigja në kërkesë me numër protokollit 3610, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga U. D. i shefit të njësisë për buxhet dhe financa z. Murat Kursani. Andaj, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se në mes të palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura, përkatësisht në punët dhe detyrat si mjek specialist gjinekolog, po ashtu nuk ishte kontestues se e njëjta realizon pagë mujore bazë prej 659.00 euro.

Kontestuese në këtë rast në mes palëve ishte se a i takon paditëses e drejta për kompensimin e pagës së 13 dhe se a ekzistojnë mundësitë buxhetore të te paditurit për pagimin e pagës së 13, kundrejt paditësit.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në

aplikim nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2018, e cila në nenin 17 paragrafi 2 ka paraparë se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”. Në vlerësimin e dispozitës se cekur si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se dispozita nga neni 17 paragrafi 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në përmbajtje lidhet me mundësitë buxhetore të punëdhënësit, pra e njëjta dispozitë nuk është e karakterit detyrues, përjashtimisht efektin detyrues e merr në rast se punëdhënësi ka buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për punëtorët e punësuar dhe që janë nën menaxhimin e tij. Pra, kjo e drejtë krijohet kur punëdhënësi (i padituri) nuk e përmbush këtë obligim, ndërsa nuk arrin që të provoj me asnjë provë se nuk ka pasur mundësi buxhetore për një kompensim të tillë.

Kësisoj, i padituri me rastin e paraqitjes se përgjigjes në padi, gjykatës i ka dorëzuar edhe provën materiale, nga e cila dëshmohet edhe gjendja financiare e tij në raport me buxhetin e pranuar vjetor për paga dhe mëditje

Nga njoftimi me numër 3823, i datës 21.12.2023, i lëshuar nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, përkatësisht nga Drejtori i Financiar z. Enver Gashi, vërtetohet se për vitin 2020, buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ka qenë në shumë prej 57,191,921.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 76,250,921.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 19,059,000.00 euro

Pra, nga njoftimi i cekur më lartë, njoftim të cilin gjykata e vlerësoj të besueshëm dhe të plotë, marrë parasysh se i njëjti është i lëshuar po nga organi dhe personi kompetent lidhur me gjendjen buxhetore tek i padituri, u provua se mundësitë buxhetore të te paditurit nuk kanë qenë qe e njëjta të veproj sipas dispozitës se nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë. Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditëses në raport me pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2020, e refuzoj për shkak se i padituri nuk ka qenë në obligim në mungesë të mjeteve buxhetore.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore të vendos jashtë seancës gjyqësore duke u mbështetur në nenin 399 të LPK-së, e cila parasheh që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, si dhe duke u bazuar në praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (rasti Jussilia kundër Finlandës, nr.73053/01), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës, obligim i cili del nga neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e morri sipas nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2598/23, datë 24.10.2024

Gj y q t a r j a,  
Fëllanza Knushaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.